

VENDIM
Nr. 419, datë 8.6.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 484, DATË 10.6.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME DHE DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E DOGANAVE TE KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, KOMISIONERI PËR
MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL DHE AVOKATURA E SHTETIT, TË
MJEDISEVE NË GODINËN E ISH-HOTEL “DRINIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i fundit, i pikës 2, të vendimit nr. 484, datë 10.6.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Një pjesë e oborrit të brendshëm, me sipërfaqe 135.30 (njëqind e tridhjetë e pesë pikë tridhjetë) m², me numër pasurie 1/501, kalon në përgjegjësi administrimi të përbashkët të të tria institucioneve të përmendura në pikën 1, të vendimit në fuqi, për t’u përdorur prej tyre.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi